



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 46
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II.
Prishtinë, më 30 dhjetor 2016, në orën 19:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nehat Baftiu, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka dhe Mirjeta Kalludra.

Munguan: Besa Baftiu, Ali Berisha, Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdullah Hoti - Ministër i MF-it. Arban Abrashi – Ministër i MPMS-së, Bekim Haxhiu - deputet, Anton Quni - deputet, Armend Zemaj - deputet, Doruntinë Maloku - deputete, Nuredin Ibishi – deputet, Hysni Gucati dhe Faton Klinaku –OVL-UÇK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Nehat Baftiu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari i Komisionit, Nehat Baftiu, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryetari u tha vazhdojmë me piken e dytë, para jush keni projektligjin si dhe disa propozim amendamente nga disa deputet, si dhe disa propozime nga Stafi Mbështetës i Komisionit të cilat do t'i shqyrtojmë një nga një. Vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e amendamenteve një nga një dhe në fund i miratojmë amendamentet në tërësi dhe i procedojmë me tej te Komisionet e përhershme.

Pasi i kemi prezent edhe përfaqësuesit e shoqatës OVL –UÇK, ju kalojmë fjalën fillimisht atyre, pastaj vazhdojmë me amendamentet.

Hysni Gucati tha se për këto amendamente që kanë ardhur ne, si shoqatë, jemi pajtuar, por kërkojmë nga ju të mos bëni ndryshime për të cilat shoqata nuk do të pajtohet. Sidomos kërkojmë nga ju që mos ta ndryshoni neni 16A, paragrafi 5, pra assesi të mos hiqet pensioni në vlerë prej 50% për veteranët të cilët punojnë.

Komisioni, pas prezantimit dhe diskutimit të Projektligjit dhe amendamenteve, votoj amendamentet një nga një, dhe nxori këtë:

Përfundim

Të procedohet me tej për shqyrtim në katër komisionet e përhershme raporti me amendamentet e miratuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Amendamentet e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të shqyrtuara dhe miratuara në komision:

Amendamenti 1. Deputetit - Nuredin Ibishi.

Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Të ndryshohet titulli i Projektligjit nga ai ekzistues: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në

“ Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtarëve të familjeve të tyre”.

Amendamenti 2. - Deputetet - Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku.

Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 3 Përkufizimet

Paragrafët 1.3.2 i Neni 3 të Ligjit bazik ndryshohet si vijon:

1.3.2. Veteran, Luftëtar i UCK-së është qytetari i Kosovës ose shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UCK-së dhe është regjistruar deri më 12 Qershor 1999, si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga Komandat, Shtabet Operative të Zonave Operative të UCK-së, përkatësisht Shtabi i

Përgjithshëm i UÇK-së, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Mbrojtja Territoriale i cili aktivisht ka marrë pjesë në luftë.

Amendamenti 3 - Komisionit FunkSIONAL

Neni 2 riformulohet si vijon:

Neni 15 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

Neni 15

Realizimi i të drejtës në pension dhe beneficione

1. Veterani, Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme i sigurohet mbështetje financiare dhe benefitet të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së.
2. Veterani Luftëtari UÇK-së i cili gjatë luftës nuk ka vepruar në Kosovë, nuk gëzon të drejtën në pension.
3. Përjashtim nga ky nen bën pjesë logjistika që ka vepruar në pika furnizimi në Shqipëri dhe në vendet fqinje.

Amendamenti 4 – dy propozime

A. Komisioni FunkSIONAL

Neni 3, riformulohet si vijon:

1. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 4 riformulohet si vijon:
4. Të drejtën në përfitim financiar e ka vetëm Veterani, Luftëtar UÇK-së, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.
2. Neni 16 të ligjit bazik, pas paragrafi 4 i shtohen paragrafët 5 dhe 6 si vijon:
5. Veterani, Luftëtar UÇK-së, që jeton në shtet tjetër, gëzon të drejtën në beneficione të tjera sipas këtij ligji, por nuk gëzon të drejtën në pension.
6. Përjashtimisht nga paragrafi 5 i këtij neni, Veterani, Luftëtar i UÇK-së, që jeton në vendet fqinje i gëzon të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj.

B. Deputeti - Nuredin Ibishi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 3, paragrafi 2: Neni 16 i ligjit bazik, paragrafit 4 të njëjtit ligj shtohen paragrafët 5a dhe 5b si vijon, nga:

5a. Veterani, Luftëtar UÇK-së, që jeton në shtet tjetër, gëzon të drejtën në beneficione të tjera sipas këtij ligji, por nuk gëzon të drejtën në pension.

5b. Përfundimisht nga paragrafi 5a, Veterani, Luftëtar i UÇK-se që jeton në vendet fqinje i gëzon të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj.

Propozohet ndryshimi dhe plotësimi nga dy paragrafët 5a. dhe 5b. në një:

Paragraf 5. “Veterani i UÇK-së që jeton në shtet tjetër ose në vendet fqinje i gëzon të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj”.

Amendamenti 5 - tri propozime

A. Komisioni funksional

Neni 4 i projektligjit, riformulohet si vijon:

Neni 4

1. Pas nenit 16 të ligjit bazik shtohet një nen i ri, si në tekstin në vijim:

Neni 16 A

1. Kategorizimi i Veteranit, Luftëtar të UÇK-së, si përfitues i pensionit dhe beneficioneve të tjera, përcaktohet në përputhje me kohën e mobilizimit dhe shërbimit në UÇK, si vijon:

1.1. Kategoria e parë, Veterani, Luftëtari UÇK-së, i angazhuar nga viti 1991 deri më 5 mars 1998 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

1.2. Kategoria e dytë, Veterani luftëtar UÇK-së, i angazhuar në luftë pas datës 5 mars 1998 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

1.3. Kategoria e tretë, Veterani luftëtar UÇK-së, i mobilizuar në luftë pas datës 31 mars 1999 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës, si dhe Veterani, Luftëtar UÇK-së, i angazhuar në luftë nga viti 1991, përkatësisht pas 5 mars 1998, por që nuk ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

2. Buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit, Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit.

3. Skema e përcaktuar në paragrafin 2, zbatohet pas kategorizimit përfundimtar.

3.1 Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit, Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është parapare me ligjin bazik.

4. Pensioni mujor i Veteranit, Luftëtar, sipas kategorive, është:

- 4.1. Kategoria e parë, 250 euro
- 4.2. Kategoria e dytë, 170 euro
- 4.3. Kategoria e tretë, 120 euro.

5. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Veteranët e Luftës së UÇK-së, të cilët punojnë jashtë institucioneve që paguhen nga Buxheti i Kosovës, si dhe në ndërmarrjet publike, do të gëzojnë pensionin njëtrajtshëm sipas paragrafit 4 të këtij neni, deri në 50% të shumës së paraparë. Por, që në total nuk do të kalon buxhetin prej 0,7% të Bruto Prodhimit Vendor.

6. Në rast të tejkalimit të 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor, atëherë reduktimi i pensionit ndodh në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj.

B. Deputetët - Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku. Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 16A i projektligjit ndryshohet si vijon;

Buxheti i përgjithshëm për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit, Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit, ndërsa pensioni i Veteranëve, luftëtarë do të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë.

C. Deputeti - Nuredin Ibishi. Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Propozoj ndryshimin e Nenit 16 A pika paragrafi 1 me nën paragrafët 1.1.; 1.2. dhe 1.3 me tekstin e ri:

“ Neni 16 A,

Paragrafi 1. Kategorizimi i Veteranit, Luftëtar të UÇK-së, si përfitues i pensionit dhe beneficioneve të tjera, përcaktohet në përputhje me kohën e angazhimit vullnetar dhe mobilizimit për shërbim në UÇK, si vijon:

Nen paragrafi 1.1. Kategoria e parë, Veteran, Luftëtar UÇK-së, vullnetar në luftë nga 01 Janar 1997 dhe ka qenë aktiv deri në ditën përfundimtare të luftës.

Nen paragrafi 1.2. Kategoria e dytë, Veterani, Luftëtar UÇK-së, i mobilizuar në luftë më 31. Mars 1999 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

Amendamenti 6 – Komisioni FunkSIONAL

Neni 5, riformulohet si vijon:

1. Neni 18 i ligjit bazik fshihet.

Amendamenti 7 – dy propozime

A. Deputetët - Anton Quni, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Paragrafi 2 i Nenit 40A, ndryshohet si vijon:

Komisioni do të përbëhet nga Përfaqësuesit e ZKM-së, MPMS-së, OVL-së dhe të ish MMRK-së.

B. Deputeti – Muhamet Mustafa - Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 7 të Projektligjit bëhen ndryshime si vijon:

1. Titulli i nenit “Komisioni për kategorizimin e veteranëve luftëtarë”, ndryshohet në “Komisioni për verifikimin dhe kategorizimin e veteranëve luftëtarë”.

2. Pas paragrafit 3 të nenit 7 shtohet paragrafi 4 si vijon:

“4. Qeveria e Kosovës, përkatësisht MPMS, në bashkëpunim me organizatat e veteranëve dhe organet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të audituar listat e veteranëve duke shmangur nga lista gjithë individët që realisht nuk i plotësojnë kushtet për gëzuar statusin e veteranit të UÇK-së.”

3. Të ndryshme

Kryetari – A ka dikush të shtojë diçka të kjo pikë? Jo. Atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje në mbledhje dhe për kontributin tuaj.

Mbledhja përfundoi në orën 20:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nehat Baftiu